



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.07.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Caktimi i datës së seancës plenare dhe kohës së debatit, mbi propozimin për ngritjen e komisionit hetimor parlamentarë, bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës z. Ilir Meta, sipas raportit të paraqitur nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për këtë çështje më 01.07.2019.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Zëvendëskryetare e Kuvendit
Elisa Spiropali –	Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Rudina Hajdari -	Kryetare e Grupit Parlamentarë Demokrat / Kryetare e Komisionit për Integrimin Europian
Nimet Musai -	Kryetar i Grupit Parlamentarë të Pavarur
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Arben Ahmetaj -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Niko Peleshi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Enver Rroshi -	Kryetar i Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë

Mungojnë:

Nyslim Murizi -	Zëvendëskryetar i Kuvendit
Fatjona Dhimitri -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve me këtë rend dite: Caktimin e datës së seancës plenare, njëherësh edhe kohën e debatit, lidhur me propozimin për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar, bazuar në kërkesën e bërë nga një grup deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta, sipas raportit të paraqitur për këtë çështje më 01.07.2019 nga *Komisioni për Çështjet Ligjore*, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Siç jeni vënë në dijeni, në datën 17 qershor 2019, një grup prej 55 deputetësh, në mbështetje të nenit 90, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 122 të Rregullores, kanë depozituar në Kuvend kërkesën për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rëndë të Kushtetutës.

Në respektim të nenit 112, pika 1, të Rregullores, në cilësinë e Kryetarit të Kuvendit kam njoftuar menjëherë Kuvendin në seancë plenare, gjithashtu, edhe Presidentin e Republikës. Po në respektim të Rregullores këtë kërkesë ia kam përcjellë menjëherë Komisionit për *Çështjet Ligjore*, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si komisioni përgjegjës, për të shqyrtuar çështjen në fjalë.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pas shqyrtimit të kërkesës, ka depozituar raportin në datën 1 korrik 2019 për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës, zotit Ilir Meta”. Sipas Rregullores, raporti është paraqitur brenda afatit 15-ditor, që parashikon neni 112, pika 2, i Rregullores së Kuvendit. Siç e keni studiuar, raporti përmban propozimin për ngritjen e komisionit hetimor. Pikërisht për këtë çështje, në përmbushje të detyrimeve që kam si Kryetar i Kuvendit, thirrë këtë mbledhje, bazuar edhe në nenin 112/3 të Rregullores, i cili parashikon se: “Kuvendi zhvillon debat në seancë plenare jo më vonë se 7 ditë nga data e paraqitjes së raportit të Komisionit për *Çështjet Ligjore*, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe në përputhje me kohën e përcaktuar në Konferencën e Kryetarëve, sipas parashikimeve të nenit 48 të Rregullores.”

Pra, me pak fjalë, Kuvendi duhet të mbledhet në një seancë plenare për të zhvilluar debatin lidhur me propozimin e bërë nga Komisioni i Ligjeve për ngritjen e komisionit hetimor. Atëherë, cilën datë do të caktojmë brenda afatit 7 ditor dhe cila është koha e këtij debati?

Fjala për ju.

Taulant Balla – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë dhe kolege,

Siç e theksoi edhe Kryetari i Kuvendit, lidhur me këtë procedurë të iniciuar nga 55 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me Kushtetutën dhe sipas pikës 3 të nenit 112 të Rregullores jemi pikërisht në momentin e përcaktimit të shqyrtimit të raportit të Komisionit të Çështjeve Ligjore në seancë dhe më pas votimin e këtij raporti dhe shqyrtimin e projektvendimit për ngritjen e komisionit. Në rast se raporti nuk miratohet, procedura ndërpritet.

Për sa më lart, dua t'i propozoj Konferencës së Kryetarëve që debati për këtë çështje, pra shqyrtimi i këtij raporti, të zhvillohet në një seancë të posaçme. Pra të mos lihet në seancën e nesërme edhe për shkak të kohës përgatitore që do të kërkonin deputetët, të cilët do të flasin, por edhe duke vlerësuar seriozitetin që ka një instancë e tillë, jemi në kushtet që prej 28 vjetësh është hera parë që Kuvendi i Shqipërisë ushtron këtë të drejtë kushtetuese për procesin e shkarkimit të Presidentit të Republikës, kjo seancë të zhvillohet ditën e hënë.

Në traditën parlamentare seancat e ditës së hënë zhvillohen pasdite, edhe për të pasur një vëmendje publike, por edhe duke pasur parasysh rëndësinë që ka kjo seancë. Pra, seanca të zhvillohet ditën e hënë, me datën 8 korrik, në orën 18:00, sigurisht me mirëkuptimin e të gjithë anëtarëve të Konferencës së Kryetarëve. Më pas, të tre kryetarët e grupeve, zonja Hajdari, zoti Musaj dhe unë do të biem dakord për kohën që do të kenë në dispozicion, duke mos harruar deputetët që nuk bëjnë pjesë në grupet parlamentare, të cilët janë një numër jo i vogël.

Propozimi im është që ky debat të mos ishte i gjatë, por të ishte konstruktiv dhe i bazuar në parime të rëndësishme të Kushtetutës e të vlerësimit paraprak të kujt do, sepse është një vlerësim paraprak derisa komisioni hetimor të bëjë gjetjet e duhura. Pra, të ketë një kohë me rreth 120 minuta, ku qoftë kryetarja e grupit të opozitës, zonja Hajdari, qoftë zoti Musaj ose unë, si kryetar i grupit të shumicës dhe si nismëtar të kemi një kohë relativisht jo shumë të gjatë, por sipas parimeve të parlamenteve moderne sot. Në Parlamentin Europian flitet për një raport të tillë jo më shumë se tri ose pesë minuta, por ne në Shqipëri sigurisht e duam më të gjatë, 30 minuta për grupin “Demokrat”, 30 minuta për grupin e “Pavarur”, dhe sa i bie proporcionalisht për grupin tonë, “Partinë Socialiste”, por besoj se edhe ne nuk do kemi

nevojë për më shumë. Pra, të kemi një seancë me një standard, ku të përcaktohet seanca se kur hapet dhe se kur është votimi, me qëllim që të jemi të gjithë aty.

Gramoz Ruçi – Ju lutem, flasim për datën, pastaj për kohën.

A ka propozim tjetër për datën? Pra, data 8 është data e fundit, kur plotësohet 7 ditëshi. Dhe kjo është me përcaktim nga Rregullorja. Zoti Balla propozon datën fundore, që është data 8.

Rudina Hajdari - Zoti Kryetar, nëse më lejohet, unë do të jap mendimin tim lidhur me këtë çështje.

Kam qenë vetë në atë seancë kur miratuam një rezolutë me presione të ndryshme, që nuk ishin të drejta ndaj opozitës duke inkurajuar deputetët e opozitës që të votonin për atë rezolutë për shkak se do të kishim një dekret tjetër të Presidentit që do të shpërndante parlamentin.

Ajo që më shqetëson është se ndodhem në mes të kësaj lufte politike. Unë jam e vetëdijshme që jam në mes të kësaj lufte politike për një shkak, por nuk dua që kjo luftë të vazhdojë. Unë e kam thënë haptazi që Presidenti i Republikës e shkeli Kushtetutën duke çdekretuar një dekret të tij, gjë që nuk ka ndodhur ndonjëherë, por, nga ana tjetër, keni zgjedhur një President, i cili është tepër politik. Ju e dini vetë këtë gjë. Jemi në një situatë jashtëzakonisht shumë të vështirë. Ne duhet të reflektojmë dhe të mendojmë nëse këta hapa realisht e zgjidhin krizën. Duhet të mendojmë nëse po e bëjmë për hir të vendit për hir të mospërplasjes e të tjera. Ndoshta do të ishte më mirë që ne të stepeshim, të bënim një hap mbrapa dhe të mos i jepnim kaq shumë bujë këtij debati në parlament. Nuk ka ndodhur ndonjëherë të kemi një precedent të tillë, që ne të shkarkojmë Presidentin e Republikës. E dimë shumë mirë se kush është Presidenti, por jemi në një situatë shumë të vështirë, prandaj unë nuk jam dakord që ne të vazhdojmë me hapat tanë dhe të përplasemi me Presidentin, sepse ju e patë se çfarë bëri Presidenti dje, e cila ishte një situatë e turpshme për të gjithë.

Nga ana tjetër ju e kuptoni se kjo vjen si pasojë e çdo gjëje që bëhet këtu në parlament. Çfarëdo që ne bëjmë, ose bëni ju në këtë rast, është një luftë politike e pastër midis maxhorancës dhe Presidentit, luftë midis jush. Ai ka marrë stafetën e opozitës, që nuk i takon dhe nuk duhet ta bëjë, por gjithsesi, kemi edhe atë shprehjen e famshme që thotë se duhet t'i hapim rrugë njërit.

Mendimi im është që të gjejmë një rrugë të mesme, sepse më pas do të raportohet në mediet ndërkombëtare dhe do të bëhemi qesharakë, do të jetë një luftë e pastër politike midis Kryeministrit dhe Presidentit.

Grupi im parlamentar do ta diskutojë edhe një herë këtë çështje, sepse ne e diskutuam dhe ramë dakord ndryshe, por pas atij ultimatumit që u dha, ata ndryshuan mendje. E di që ju kërkon bashkëpunimin tonë, por unë flas më shumë personalisht si deputete dhe si kryetare e Komisionit të Integritetit, që nëse ia vlen që ne të vazhdojmë të procedojmë në këtë lloj mënyre, edhe nëse kjo gjë e dëmton imazhin e Shqipërisë dhe e përshtjellon situatën, duke na çuar në një situatë tjetër konfliktuale. Çfarë do të ndodhë? Ai do vetëm të ngrejë alarmin në media. Ku është zgjidhja këtu? Unë nuk shoh asnjë zgjidhje. Ndoshta dënimi më i madh është që ai të rrijë aty brenda, kështu që në këtë mënyrë e keni zgjidhur situatën!

Unë do të kërkoja një reflektim nga ana e deputetëve të maxhorancës, nga kryetari i grupit maxhoritar dhe nga ju si Kryetar i Kuvendit, në mënyrë që ne të mos e përshtjellojmë situatën dhe të mos i japim më shumë shkak Presidentit që të vazhdojë në këtë lloj mënyre.

Faleminderit!

Taulant Balla - Unë dua të nënvizoj shqetësimin që shprehu kryetarja e grupit të opozitës, zonja Hajdari, për një kërcënim nga ana e Presidentit të Republikës për të shpërndarë Kuvendin. Qëndrimi i tij për këtë çështje është bërë publik, por kjo nuk është një çështje që mund ta diskutojmë sot apo ndonjëherë, sepse Presidenti i Republikës, për fat të mirë, nuk e ka këtë të drejtë.

Lidhur me kompetencat e Konferencës së Kryetarëve, dua t'ju bëj me dije se ditën e hënë kjo Konferencë përcakton seancën për shqyrtimin e raportit të Komisionit të Çështjeve Ligjore dhe Administratës, që është një zbatim rigoroz i Rregullores. Kuvendi nuk e voton shkarkimin ditën e hënë. Bie dakord fjalë për fjalë me zonjën Hajdari që Presidenti i Republikës e ka shkelur rëndë Kushtetutën. Këtë do ta vlerësojë komisioni hetimor, i cili, bazuar në një ekspertizë të mirë, do të dalë në përfundim.

Sipas pikës 4 të nenit 112, kur të kemi një raport në dorë, do të kemi 20 ditë kohë në dispozicion për ta vlerësuar, sipas Rregullores. Nëse e ka shkelur apo jo, këtë vlerësim duhet ta bëjë komisioni hetimor.

Në çdo rast Kuvendi i Shqipërisë duhet të jetë institucioni që të japë mesazhin e qartë që në Shqipërinë e vitit 2019, kushdo që shkel ligjin, për më rëndë akoma, ligjin

themelor të shtetit, Kushtetutën, duhet të vlerësohet nëse e ka bërë këtë. Unë mendoj se është në dinjitetin e këtij Kuvendi që të ngremë komisionin hetimor për të vlerësuar nëse Presidenti e ka shkelur apo jo Kushtetutën. Pastaj, në detyrat specifike që ka ky komision, do të vlerësojë nëse Presidenti ka bërë shkelje të rëndë apo të lehtë, pavarësisht se unë personalisht hyj tek ata persona që mendojnë se shkelja e Kushtetutës është gjithmonë e rëndë, por këtë gjë do ta ndajnë juristët.

Vlerësoj propozimet konstruktive që vijnë nga zonja Hajdari, dhe, meqenëse jam edhe nismëtar, në pjesën e dytë të kësaj mbledhjeje do të doja të bashkëndaj me ju reflektimin tonë në bazë të kërkesës suaj, që lidhet me Kodin Penal, por në këtë rast, 55 firmëtarët duan që kërkesa e tyre të ezaurojë të gjitha etapat deri në etapën përfundimtare, atë të votimit të Kuvendit dhe më pas të certifikimit të saj nga Gjykata Kushtetuese kemi ende shumë kohë në dispozicion. Pra, edhe një herë në atë që tha dhe vlerësoi Kryetari i Kuvendit, propozoj datën 8 korrik, ora 18:00, ta zhvillojmë këtë fazë të pikës 3, nuk kemi shkuar ende të pika 4 e procedurës që do të kërkojë edhe shumë kohë. Pastaj një diskutim për kohën, të bëhet veçmas. Më pas te pikat e tjera do të diskutoja diçka që lidhet me një kërkesë shumë konstruktive të zonjës Hajdari. E falënderoj që e bëri në kohën e duhur dhe ne kemi reflektuar mbi atë.

Gramoz Ruçi – Po sqaroj një gjë, meqenëse m'u drejtuar: kjo mbledhje, ky kuorum nuk ka asnjë të drejtë të vendosë, nëse duhet të vazhdojë kjo procedurë apo jo. Kjo është me detyrim përcaktim. Ka dy rrugë: e para ajo që parashtoi zonja Hajdari, nëse kërkesit e tërheqin nismën, unë e ndërpres procedurën këtu, sepse nuk kam se çfarë të diskutoj.

E dyta, do të shkojmë në seancë dhe do shkojmë brenda 7 ditëve, kjo nuk ka diskutim, është me detyrim përcaktim, pasi na e përcakton Rregullorja që brenda 7 ditëve t'ia dërgojmë seancës. Seanca vendos ose jo për ta ngritur komisionin, pra e miraton ose nuk e miraton ngritjen e komisionit hetimor. Kjo është e drejta juaj, e diskutoni brenda grupit, midis gupeve. Pas debatit do të votoni. Si do të vendosni?! Jeni ju që do të vendosni.

Problemi i tretë është që pasi ngrihet komisioni hetimor, pasi bën hetimin, sjell një raport në Kuvend, Kuvendit i jepet 20 ditë kohë për të reflektuar për këtë raport, i cili do të jetë në përfundim të këtij debati, të kësaj seance. Ju do të votoni. Ai votim është përfundimtar për Kuvendin dhe këtu Kuvendi mbaron punën e tij, por kjo nuk do të thotë se është shkarkuar Presidenti, është Gjykata Kushtetuese, e cila shprehet për këtë vendim që ka marrë Kuvendi.

Prandaj, ju lutem sot keni vetëm dy gjëra: cila është data që do ta diskutojmë dhe sa kohë doni për debatin? Ju lutem shprehuni për datën! Pastaj, sesi do të vendosni ju politikisht nëpërmjet votës, mendimin që do të jepni dhe votën që do të jepni, janë puna juaj. Prandaj për datën...

Rudina Hajdari - Dakord, zoti Kryetar. Unë e kuptoj pikëpamjen tuaj, që këto janë nga ana procedurale dhe duhet marrin një vendim. Nga ana tjetër, jemi edhe në kushtet kur nuk kemi Gjykatë Kushtetuese, gjë që e bën situatën akoma më të vështirë, sepse si mund ta vazhdojmë një procedurë, nëse nuk e dimë tamam se kur do të ngrihet Gjykata Kushtetuese, e cila merr vendim mbi këtë çështje.

Pra, duke qenë në kushte jonormale, situata bëhet më e vështirë për të marrë një vendim të prerë. Siç e thatë edhe ju, nismëtari mund ta reflektojë këtë nismë. Patjetër që ai ka të drejtën e tij dhe mund të vazhdojë me këtë, por unë do të kërkoja nga grupi im parlamentar, që të mos e ezaurojnë kohën e tyre, sepse mendoj se grupi ynë duhet të ketë një qëndrim të qartë, që është mosnxitja e konfliktit me Presidentin. Nëse ju vazhdoni me këtë, është puna juaj, por opozita nuk do të vazhdojë. Nëse është fjala për shkarkim, patjetër që atë do ta vendosë Gjykata Kushtetuese, por duke parë se nuk kemi Gjykatë Kushtetuese, dhe kjo mund të përdoret thjesht si një lloj mekanizmi për ta tensionuar situatën, unë jam e shqetësuar. Kaq! Është shumë e thjeshtë.

Gramoz Ruçi – Mirë, dakord! Lidhur me datën, a ke vërejtje? Është e drejta juaj të gjykoni, të vlerësoni e të votoni si të doni, po për datën a biem dakord? A biem dakord të jetë më datën 8? Ka vërejtje tjetër? Ka datë tjetër?

Urdhëroni!

Ulsi Manja – Kryetar, unë jam plotësisht dakord, që data 8 e propozuar nga zoti Balla, si kryetar i grupit, është data limit, siç përcakton neni 112, pika 3 e Rregullores.

Kërkuesit këmbëngulin te nisma, Komisioni i Ligjeve ju ka sjellë një raport konkret më datën 1 korrik, dhe sipas nenit 112/3, brenda shtatë ditëve Kuvendi cakton seancën për diskutimin e raportit dhe propozimin për ngritjen e Komisionit Hetimor. Data 8 është afati limit dhe s'ka datë tjetër përtej datës 8. Kësisoj, unë jam plotësisht dakord që data 8 të jetë data e diskutimit të raportit.

Gramoz Ruçi – Ka propozim tjetër?

Atëherë, dakord me datën 8?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është e fundit.

Atëherë, biem dakord me datën 8, që është afati limit i përcaktuar nga neni përkatës i Rregullores.

E dyta, në lidhje me kohën e debatit. Sa orë mendoni të jetë? Sa kërkon çdo grup parlamentar. Jo vetëm ju, por edhe pjesa tjetër, që hyjnë tek të pavarurit. Duhet të llogarisni se radhën e parë u latë shumë pak kohë atyre, dhe ky është një numër jo i vogël deputetësh.

Taulant Balla - Tani, unë propozoj që debati të jetë tri orë dhe të pranojmë se gjatë diskutimit për rezolutën nga ana e Kuvendit është evidentuar shkelja e Kushtetutës dhe kjo është një fazë procedurale, siç e theksoi edhe Kryetari i Kuvendit. Kështu që tre orë, proporcionaliteti i të cilës përcaktohet sipas Rregullores, në fillim maxhoranca-opozitë dhe pastaj brenda opozitës kemi tri grupe: Grupi i Deputetëve Demokratë, të Pavarur dhe grupi jashtë grupeve parlamentare të pavarur. Nëse janë 180 minuta, të ndahet në 100 minuta maxhoranca dhe 80 minuta opozita, e cila mund të marrë kohën e saj, ku zonja Hajdari tha: “Mjafton një diskutim”, por gjithsesi kohën do ta kenë, e cila mund të ndahet në: 30 minuta për Ju, 30 minuta grupi i Pavarur dhe 30 minuta deputetët e tjerë. Pra, debati të jetë 190 minuta, 3 orë e 20 minuta, 110 me 90.

Mimi Kodheli – Unë mendoj se tri orë janë shumë. E justifikoj këtë deduksion duke u nisur nga fakti që ne kemi bërë një debat, ku kemi diskutuar për rezolutën. Së dyti, për çdo individ nuk mund të ketë më shumë se 10 minuta, kështu që mendoj se mund të jetë më pak se tri orë, mund të jetë edhe dy orë. E kemi bërë debatin një herë dhe maksimumi ka qenë 10 minuta. Ky ishte thjesht një propozim, më racional është i zotit Manja.

Gramoz Ruçi – U lutem, kryetarët e grupeve!

Nimet Musaj – Faleminderit, Kryetar!

Duke dëgjuar edhe diskutimet e kolegëve, normalisht dy orë do të ishte një diskutim normal për këtë seancë të jashtëzakonshme, ku të gjithë deputetët që do të marrin fjalën të japin mesazhe. Duke parë edhe situatën, normalisht për të dhënë gjithsecili mesazhin pozitiv, 3 orë ndoshta janë shumë. Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Zonja Hajdari.

Rudina Hajdari – Ashtu siç e parashtrova në fjalën time, ne nuk do të marrim pjesë në këtë debat. Patjetër që mund ta diskutoj edhe një herë me grupin, por mund t'ia dhurojmë kohën maxhorancës.

Siç e tha edhe zonja Kodheli, e kemi diskutuar një herë, do të fillojmë të përsërisim të njëjtën gjë. Nuk dua të bëhem e mërzitshme, por, për mua, ky debat nuk ka më kuptim.

Gramoz Ruçi – Është e drejta juaj që ta bëni debatin 10 orë, ose edhe 30 minuta, domethënë është e drejta juaj. Këtu shprehet qëndrimi dhe votohet, kaq, domethënë, të ngrihet apo të mos ngrihet komisioni.

Rudina Hajdari – Dakord.

Taulant Balla – Kujtoj për ata që e kanë harruar, në këto debate me kohë të përcaktuar, qoftë Kryeministër, qoftë ministër apo kushdo qoftë tjetër, llogaritet në kohën e maxhorancës. Pra, nuk ka asnjë të drejtë të dalë përtej kësaj kohe dhe, si e tillë, 1 orë e 30 minuta për maxhorancën është e koha e mjaftueshme për t'u ezauruar. Në fund të fundit, kemi parasysh që edhe prezantimi i raportit të Komisionit të Ligjeve nga kryetari i komisionit të futet pikërisht në kohën e grupit të shumicës dhe 3 orë... Nëse, për fat të mirë, apo të keq, si të doni, do të ketë nga ata që tërhiqen, kjo ul kohën e debatit. Por është më mirë të kemi një kohë maksimale, të cilën mund ta ulim, se sa më pas të shkelim vendimin e Konferencës së Kryetarëve nëse do të duhet më shumë kohë për diskutim. Në fund të fundit, deri të hënën, me këtë vrull politik që ka Shqipëria, mund të ndodhin shumë çështje, të cilat deputetët duan t'i ndajnë me popullin, për shkak se deputetët janë votuar për të folur në parlament. Faleminderit!

Atëherë, 200 minuta gjithsej, 110 me 90. Pra, 110 minuta shumica dhe 90 opozita, më pas opozita i përdor, nuk i përdor... Ndoshta edhe ne nuk i përdorim 110 minuta, por t'i kemi në parim. Votimi i bie të bëhet në orën 21:30 dhe populli na shikon.

Rudina Hajdari – Siç e thashë, unë nuk mendoj se koha prej tri orësh është e domosdoshme. Kështu, ose biem dakord me 2-orëshin, ose më mirë tërhiquni. Ky është të paktën minimumi që mund të bësh, se nuk po të kërkohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe për sa i përket kryetarit, ke dy kryetarë opozite, të cilët nuk mendojnë se është e nevojshme të kemi tri orë. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Ju lutem! Biem dakord ta lëmë gjithsej dy orë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, si ndahet kjo?

(Deputeti Balla flet pa mikrofon.)

Taulant Balla – Kini parasysh që ju përfaqësoni 23 deputetë nga 45 deputetë, çka do të thotë se gjysma e deputetëve të opozitës nuk bëjnë pjesë te grupet parlamentare respektive të përfaqësuara këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të paktën, sikur atyre 25 deputetëve t'u lëmë nga një minutë kohë të flasin, duhen 25 minuta. Por normaliteti kërkon që t'u lihen 2 minuta, aq sa është...

(Deputetja Hajdari ndërhyr pa mikrofon.)

Detyra ime është të mendojmë pak më gjerë, prandaj e kisha këtë merak. Megjithatë, e lëmë 70 me 50 dhe jemi në rregull.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Sa kohë keni...

(Diskutime në sallë)

Atëherë, mbetemi te 2-orëshi, nga 20 minuta...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqenëse votuat ashtu, t'i lihet nga 20 minuta secilit grup. Pastaj, nëse grupet duan më pak, të ulet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Biem dakord, zoti Balla, të lihen gjithsej 130 minuta, pra 2 orë e 10 minuta, me qëllim që të tria grupimet politike të kenë kohë të barabartë?

Taulant Balla – Si të barabartë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Pastaj, e përdorin, nuk e përdorin, është problemi i tyre.

Taulant Balla – Nuk e kuptova termin “të barabartë”, 70 me 60.

Gramoz Ruçi - 70 me 60, duke u lënë nga 20 minuta të dyja grupeve dhe, po ashtu, 20 minuta grupimeve të deputetëve të pavarur. Më pas, nëse përdoret apo jo, e dinë vetë. Dakord?

Taulant Balla – Dakord.

Gramoz Ruçi – Keni gjë tjetër?

Taulant Balla – Zoti Kryetar, kam edhe diçka për të shtuar.

Gramoz Ruçi – Po.

Taulant Balla - Në seancën e fundit të Kuvendit të Shqipërisë, nga ana e deputetëve të opozitës, flas për të dyja grupet parlamentare të opozitës, u parashtrua kërkesa që dy ndryshimet e propozuara në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë të shtyhen, me qëllim që të bëhet një diskutim më i thelluar nga ana e grupeve. Unë jam dakord, e kam thënë edhe në seancë plenare, por do të doja që të mos jenë në seancën e ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, zonja Hajdari, nuk tërhiqemi, por po them të mos jetë në seancën e nesërme. Unë kërkoj mirëkuptimin tuaj që deri në përfundimin e sesionit të keni një këndvështrim për çështjet e vendosura. Ju kujtoj se është një domosdoshmëri që dhuna në stadione, dhuna në spitale apo problematika të tjera si, për shembull, për sigurinë ushqimore duhen adresuar me urgjencë dhe nuk mund të jenë pjesë e një pengu politik, qofshi ju apo kushdo tjetër. Faleminderit!

Rudina Hajdari – Dua të informoj se jam duke folur me disa nga kolegët tuaj, edhe me ata që janë anëtarë të Komisionit të Ligjeve për ndryshimet që ne do të propozojmë; por unë e kisha fjalën për nenin shtesë që u propozua nga deputeti Bushati. Çfarë do të bëhet me atë nen? Do të hiqet?

Taulant Balla – Do të të jap një përgjigje për këtë çështje, kur të biem dakord për datën në seancë plenare.

Rudina Hajdari – Ne kemi rënë dakord paraprakisht. Pra, në momentin që do t'i paraqesim amendamentet në Kuvend, të biem dakord dhe më pas të shikojmë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA